



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6952 Prot

Gjirokastrë më 02 : 08 :2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 31.07 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.07 .2024.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në 31.07 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:50, pas një shtyrje prej 45 min .

Marrin pjesë në mbledhje 16 anëtarë. Mungojnë në mbledhje ,Llogo,Çabeli,Feruni, E.Shehaj, Aliko, Kore, Mahmutaj, Rova, Binozi, Kondi, Drasa, Novi,Cacaj,Qeli.

Znj. Ardita Koçollari është online nëpërmjet sitemit audio video.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 05.07.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.07. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.07. 2024”.

4.P/Vendim “Për vendosjen në Shtëpinë e të Moshuarve “Shpresa e Jetës”.



5.P/Vendim “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bardhosh Gaçe”.

6.P/Vendim “Për miratimin e taveve të rishikuara 2025-2027”

7.P/Vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile”

8.Trajtim i kërkesave të qytetarëve.

9.Të ndryshme.

Miratohet me 16 vota pro rendi i ditës së mbledhjes.

Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 05.07,2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.07. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-10.07. 2024”, të cilat miratohen me 16 vota pro.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës: 4.P/Vendim “Për vendosjen në Shtëpinë e të Moshuarve “Shpresa e Jetës”.

Znj. Isaraj: Materiali është I plotë. Nëse keni ndonjë pyetje, kemi këtu Drejtoreshën e Shërbimeve sociale pranë Bashkisë.

Z. Muho: Të njoftohet për mbledhje edhe Drejtoresha e Shtëpisë së të Moshuarve.

Miratohet me 16 vota pro p/ Vendimi “ Për vendosjen në Shtëpinë e të Moshuarve të znj, Sadika Mamani”

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës: 5.P/Vendim “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bardhosh Gaçe”.

Z. Guçe: Nuk di që të ketë bërë gjë për Gjirokastrën, ne jemi zgjedhur me votat e qytetarëve gjirokastritë dhe kemi përgjegjësi për ata. Ka plot emra që duhen nderuar nga Gjirokastra.

Z. Brahimi: Me titujt që ka si profesor dhe veprat e tij jam dakord , por a është Qytetar Nderi për Vlorën dhe Tepelenën ?Personalisht nuk jam dakord .



Znj. Isaraj: Ky është professor I nderuar, i cili ka bërë studime në fushën e plifonisë, për futjen ne UNESCO të Polifonisë, studime për Festivalin e Gjirokastrës.

Z. Kristidhi; Komisioni është shprehur dhe ishte dakord.

Z. Hilaj: Është vlerësim I qytetit , nuk duhet të tallemi kur jepen tituj nderi.

Znj. Isaraj : Patjetër që ka bërë edhe për Gjirpkastrën, por mbase nuk dini gjithçka për veprat e tij.

Hidhet në votë dhe miratohet me 13 vota pro dhe tre kundër P/Vendimi “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Bardhosh Gaçe.

Kalohet te pika 6 e rendit të ditës.”P/Vendim “Për miratimin e tavaneve të rishikuara 2025-2027”

Sqaron znj Artiste Koko për pikën 6 dhe 7.

Material është hapi i pare i fazës së dytë për të ardhurat afatmesme 2025-2027 me rritjen e të ardhurave të veta është parashikuar rritje 1% për secilin vit.

Nuk kemi ndryshime nga materiali i miratuar nga ju në shkurt 2024

Pasi të kalojë të gjitha fazat nëpërmjet një urdhëri të brendshëm nga Kryetari I Bashkisë dhe pasi të konkludohet me të gjitha zyrat në shtator mbyllet faza e dytë Hapet në tetor faza e fundit për PBA 2025-2027 dhe për buxhetin vjetor 2025.

Z. Brahimi: Pse vetëm 1% kur çmimet janë rriturr, kush I kontrollon?

Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro” Për miratimin e Tavaneve të Rishikuara Përgatitore Buxhetore në Nivel Programi për PBA 2025-2027 në Bashkinë Gjirokastër”.

Kalohet te pika 7 e rendit te dites. “Për miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile”

Z. Brahimi: Zjarret vendosen me dorë, duhet monitorim me kamera termike për territorin.Nuk fiken zjarret me shkarpa, duhen politioka për mbrojtjen nga zjarri.

Z. Hilaj : Në buxhetin e vitit të ardhshëm të parashikohet vendosja e kamerave termike.Në analizën e dy muajve me parë të DMZSH ne e diskutuam dhe ju kërkua të paraqesnin kërkesadhe të miratonim po të kishin nevoja konkrete.

Të mos harrojmë se para 3 vitesh u dogjëm dhe humbëm edhe jetë njeriu.. Të mos jepen kontrata më në zonat ku bie zjarr, se ky është krim, as pushtuesit më të egër nu kia kanë bërë këtë dëm natyrës dhe shëndetit të qytetarëve.



ZNJ. Koko: Nësë e miratoni sot na ka ardhur një kërkesë për një fond 150 .000 lekë

Hidhet në votë dhe miratohert me 16 vota pro, me shtesen prej 150.000 lekë në fondin për emergjencat civile .

Kalohet te kërkesat e qytetarëve, për kërkesën e pallatit te “Kodra e Shtufit”. Kjo kërkesë I është deleguar zyrave përkatëse

Z. Guçe Të ndërhyet te sinjalistika e monumenteve të jenë orientuese dhe informuese

Te Memoriali i Valltarëve në hyrje të qytetit të ndërhyet për pastrimin dhe larjen e monumenteve.

Z. Çuçani: Nuk ka qytet pa semaforë, vetëm qyteti ynë është i tillë.

Znj. Amarilda Lelaj: Plani mobilitetit për lagjen “18 Shtatori” u mbyll dhe ekspertët nuk e parashikuan, sepse sipas tyre nuk duhej.

Z. Nurçe: Ne bëjmë këtu Qytetarë Nderi por duhe të ndërhyet se Pazar është kthyer në mencë publike . Drejtoria e Turizmit a ka ndonjë strategji për turizmin?

Duhet strategji dhe paketë ligjore.

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj në orën 13:40 min.

**Sekretar**

**Etleva YZO**

**KRYETAR I KËSHILLIT**

